



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA GJIROKASTËR  
KËSHILLI I BASHKISË

V E N D I M

Nr. 66 datë 02.10 2024

P E R

MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË  
STREHIMIT "SUBVENCIONI I QIRASË 2025"

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutë, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b", nenit 24, nenit 54 shkronja "k", nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjin nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018, Për Strehimin Social", vendimit nr. 361 datë 29.05.2019 "Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional", vendimit nr. 362, datë 29.05.2019 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë", vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 02.10 2024

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit "Subvencioni i qirasë", hartuar sipas udhëzuesit operacional bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, Drejtoria e Financës, Njësitë Administrative dhe Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

